



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01- 7060/24
Kaçanik, 26.03.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **III (tretë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 26 mars 2024 (E Martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 13:00. Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Lejla Muhamheri-Çaka-PDK, Arben Thaqi- OJQ. Nga Ekzekutivi i komunës në takim mori pjesë z.Zahir Doda – Drejtës i Arsimit.

Mbledhjen është udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Prosesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e III-të (tretë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2024, data 26 mars, me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. Gjendja e Arsimit në komunën e Kaçanikut; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rrëth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Komitetit për Komunitete.

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rrëth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbali ? Prosesverbali i mbledhjes së II (dytë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2024, u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e, Aprovoh

Prosesverbalin e mbledhjes se II (dytë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2024, të datës 26.02.2024 / Lënda : 01Nr. 60/01-4598/24.

2. Gjendja e Arsimit në komunën e Kaçanikut;

Z. Zahir Doda: Sipas statistikave mësimin e vazhdojnë në gjitha nivelet 5,433 nxënës të cilët udhëhiqen nga një staf arsimor konkretisht punëtor arsimorë, me punëtor teknik me staf profesional janë 529.

Sfidat kryesore të cilat paraqesin shqetësim të madh për të gjithë arsimin në Kosovë por edhe për neve është zvogëlimi çdo ditë i numrit të nxënëseve. Fatmirësish nuk kam lëvizje të punëtorëve qysh e kam menduar se do të kem, kështu që procesi mësimor zhvillohet në gjitha shkollat pa probleme, këtu mund ta ceki që nuk kam orë të pa mbuluara, përveç që në lëndën e gjuhës gjermane që kemi pasur disa probleme pasi që kemi pasur konkursin e shpallur por nuk është paraqitur askush, edhe në disa orë të lëndës së fizikes. Prandaj gjuha gjermane dhe lënda e fizikës janë dy lëmi në arsim për të cilat kemi mungesë të kuadrore ndërsa sa i përket lëndëve të tjera janë të gjitha në rregull.

Po mundohemi që përmes zyrës së personelit me i plotësua të gjitha vendet e lira, konkursin e rregullt e kemi shpallur përmes zyrës se personelit me ç 'rast kanë filluar rekrutimet për ketë vit andaj shpresoj që edhe në muajin shtator nuk do të kemi lëvizje të mëdha të mësimdhënëseve. Ju njoftojë që tani për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënëseve, me saktësisht në muajin maj të vitit të kaluar për qarkoren e parë buxhetore jemi njoftuar prej Ministrisë arsimit, se duhet me zvogëluar numrin e punëtoreve për 13, ku edhe në muajin janar i kemi pasur 13 paga më pak. I kemi pasur 542 mësimdhënës mirëpo tani ka qenë obligative me ulë numrin e mësimdhënësve deri në 529. Shpesh herë po interpretohet se nuk po i dëshirojmë ti angazhojmë të rinjtë në punë, mirëpo nuk ka mundësi duke marr parasysh që mbeten jashtë listave të pagave, momentalisht asnje person nuk e kemi jashtë listës së pagave, të gjithë janë në lista pasi që kemi arritur ta zvogëlojmë këtë shifër deri në numrin fiks të paraparë 529.

Aktualisht si sfidë po e pres muajin maj të këtij viti, sepse në muajin maj shpërndahet qarkorja e parë buxhetore edhe na paralajmërojnë, ka mundësi qe përsëri me na paralajmërua që në vitin 2025-të sa punëtorë duhet me i zvogëluar dhe duhet me fillua rekrutimi përndryshe do të kisha pasur dëshirë shumë të madhe qe me shpall sa ma shumë vende pune qe mos me i lenë të rinjtë jashtë procesit mësimore mirëpo e kam të kufizuar numrin e pagave.

Sipas planifikimeve tona, kemi të planifikuara dy çerdhe shkollore (çerdhja në Rekë dhe çerdhja në Kaçanik të vjetër) të cilat janë në procedurë. Për çerdhen në Rekë, është ndarë parcela d.m.th. është destinuar dhe është dhënë edhe leja e ndërtimit. Në rastin në fjalë ministria ka reaguar menyerë dhe e ka lejuar, për këtë e kemi edhe projektin detal që na kanë dërguar, e kemi lëshuar edhe lejen e ndërtimit dhe e kemi përcjell atje, tani është faza e tenderimit dhe tenderimin e zhvillon ministria andaj pritet që të paktën sipas deklaratave të ministrisë nëse ju shkojnë punët si duhen, ketë vere të fillonë çerdhja në Rekë e cila është e paraparë për 40 fëmijë.

Për çerdhen në Kaçanik të vjetër, procedurat tona si komunë i kemi kryer të gjitha, është ndarë parcela dhe është destinuar për çerdhe, janë dërguar të gjitha dokumentacionet e nevojshme dhe për informimin tuaj ka qenë dokumentacioni më i kompletuar prej gjitha komunave tjera në bashkëpunim me mua kemi pas menduar IPA fondet e IPA-së së Bashkimit Evropian po i ndertojkan do çerdhe pak më të mira edhe ajo ketë vite ka pasur me filluar mirëpo për shkak këtyre masave qe kemi sot për sot thjesht i ka bllokuar fondet IPA Fondi dhe nuk niset , dokumentacioni është komplet mirëpo deri sa të shkrijhen ato masa dhe si pas gjitha gjasave as këtë vit nuk fillojnë

Shkolla “Emin Duraku” është në kod të ministrisë, e kanë kontraktuar kompaninë për projektim për dizajn, unë e kam dorëzuar dokumentacionin në ministri komplet. Kompania për dizajnim të projektit ka qenë këtu një 3 herë dhe është duke bashkëpunuar me neve, na ka dërguar një projekt ideor dhe në këtë sallë i kam mbledhur të gjithë inxhinierët edhe të urbanizmit dhe të njëjtë e kanë vlerësuar qe herën e parë ministria e ka përcjell numrin e nxënësve gabim prandaj projekti nuk është bërë me standarde siç duhet me u bërë duke marrë parasysh që për këto objekte shkollore ka udhëzim administrative në të cilat specifikohen qartë se cilat standarde duhet të plotësohen nuk mundet çfarë do dhe ata janë të obliguar me ju përbajt udhëzimit administrativ, për madhësinë e klasës, sa klasë për numër të nxënëseve, objekte të tjera përcjellëse andaj ne e kemi kthyer atë. Kompania është përgjigjur që prej ministrie e ka marrur këtë numër për 550 nxënës dhe e kanë berë projektin, ndërsa unë e kam dorëzuar për 1,040 nxënës edhe me kanë thënë për këtë me reagua në ministri, edhe kam reaguar dhe kam dërguar projektin e dytë të cilin e kanë kontrolluar edhe dy herë, andaj është marrë qëndrim unanim i këtyre të urbanizimit dhe inxhinierët te shërbimet publike dhe kane ardhur në përfundim që projekti është i mirë, i përshtatet atij vendi, ç ‘rast ne e kemi dhënë sinjalin pozitiv lidhur me këtë dhe janë duke e punuar projektin detal. Ne jemi në fazën e lëshimit të lejes së ndërtimit edhe ata na ka premtuar se këtë vit do të filloj tek Emin Duraku pjesa tjetër e infrastrukturës. Kemi të planifikuara do disa salla të edukatës fizike dhe në të gjitha shkollat që kanë një numër pak ma te madh të nxënëseve na ka shkuar sipas planit, një veç përfundon në muajin qershor në fshatin Biqec, janë bërë përgatitjet të filloj në fshatin Bob dhe në vitin e ardhshëm përfundon Bobi, madje do të filloj në fshatin Dubrave.

Çështjen e sigurisë nuk e kemi si duhet dhe është shqetësuese kjo pasi që po ballafaqohemi me probleme që as zgjidhje nuk mund ti japim. Është problemi me të mitur ku edhe kemi disa raste të fëmijëve që ne realisht kemi mundësi me i transferua prej një shkolle në shkollën tjetër mirëpo nuk është duke pasur efekt hiq. Ka fëmijë që paraqiten me armë kemi pasur edhe kësi raste, jemi tu mundu dhe tu marr me këtë problematike sepse është bërë e vështir edhe puna e mësimdhënësit por ky është trend i përgjithshëm nuk është vetëm tek ne. Me policin e Kosovës kemi raporte tepër të mira, na përgjigjen në çdo thirrje dhe na kanë ndihmuar shumë, realisht e keqja më e madhe këtu është që një pjesë e madhe e prindërve nuk e kanë kontrollin mbi fëmijët e tyre, kjo gjë është e rendë dhe është për keqardhje!!!

znj.Arta Avdiu: Me 1 shtator të vitit 2023, shkolla fillore e mesme “Naim Frasheri ” në fshatin Kotlin ka pushuar veprimtarinë edukative arsimore për shkak te rënies të numrit nxënëseve. Duke marrë parasysh që ky trend (zvogëlimi i numrit të nxënësve) vazhdimisht është në rritje, a ndikon të mbylljet edhe ndonjë shkollë tjetër?

z.Zahir Doda: Për mbylljen e një institucionit arsimor në këtë rast shkollave ekzistojnë procedura të cilat i nënshtrohen udhëzimeve administrative të fushës arsimore. Ne ju kemi përbajtur komplet këtyre udhëzimeve administrative, ka qenë komisioni edhe prej ministrisë por edhe unë gjatë verës kam pasur takim edhe me prindërit kur është mbyllur shkolla “Naim Frashëri”, dhe krejt në fund kanë mbetur vetëm 3 nxënës prej klasës së parë deri në të nëntën, prandaj ka qenë e pamundur sepse është e dhimbshme me u mbyll shkolla dhe saktësisht qysh e kërkon udhëzimi administrativ e kemi bërë sistemimin e të gjithë mësimdhënëseve, pra asnjë mësimdhënës nuk ka mbetur pa punë, nxënësit po i bartim me vetura sepse jemi të obliguar me e realizua bartjen e nxënëseve në pajtueshmëri me prindërit. Këta nxënës i kemi dërguar në fshatin Kovaçec, sepse janë dy

nga klasa dytë dhe një i klasës së tetë. Pasi që Kovaçeci punon me një ndërrim një pjesë të dokumentacionit e kemi dërguar në Ivaj sepse e kanë një lidhje Ivaja me Kotlinën, atje janë bart sepse duhet me u sistemua ndërsa një pjesë e inventarit në marrëveshje me komisionin ku kanë pasur nevojë shkollat e kemi shpërndarë nëpër shkolla, kurse bankat dhe karriget dhe objekti qëndron, për shkak se është një vend që organizohen tubime andaj kemi kërkuar që administratori me i marr çelësat por ende nuk i ka marrë dhe që kurdo që të ju nevojitet si objekt me shfrytëzua atë.

Gjendje kritike e kemi në fshatin Ivajë ku atje janë 17 nxënës nga klasa 1 deri 9 dhe nuk e di se si do të veprojmë, ndërsa fshati Runjev është stabilizuar dhe do të funksionoj. E kemi edhe një shkollë në fshatin Vatë, është një paralele e ndarë dhe është numri i vogël i nxënëseve. Vata dhe Ivaja janë në dilema për mbyllje megjithatë në Ivajë unë kam bindjen që edhe nëse mbylllet do mbylllet vetëm cikli i nalt ndërsa ciklin e ulet nuk e kam ndërmend me mbyll, do ta mbaj derisa të vjen puna me 3 deri 4 nxënës.

z.Ekrem Livoreka: Lidhur me procesin e shkollës në fshatin Kotlin, sa ka qenë e vështir të bëni sistemimin e mësimdhënësve nëpër shkollat e tjera?

z.Zahir Doda: Natyrisht se ka qenë pak problem por e kemi edhe një hapsirë edhe nga Ministria Arsimit e cila na ka dhënë disa mundësi që në rastet qe mbetet pa zgjidhje ndonjë mësimdhënës qe i ka 15- 20 vite përvojë pune, kemi të drejtën me sistemua diku tjetër.

z.Arben Thaqi : Jam në dijeni që jeni duke bërë punë shumë të mira lidhur me arsimin. Kam vërejtur përparësitë dhe mangësitë lidhur më gjendjen në arsim, ku si përparësi mund të veçohet shpenzimi i udhëtimit të nxënëseve prandaj jeni prej komunave që në aspektin pozitiv dalloni prej komunave tjera, ndërsa sa i përket mangësive unë kam vërejtur mangësitë tek ndërtimi i shkollave dhe sallave edhe pse tanë janë duke u berë disa lëvizje ne këtë drejtim, dëshiroj ti shtroj disa pyetje lidhur me këto mangësi si:

Lidhur me furnizimin e shkollave me material shpenzues dhe menaxhimin shkollave si dhe në procesin e dixhitalizimit , sa janë pajisur shkollat me tabela digjitale apo me projektor si dhe materiale të tjera shpenzuese pasi që kemi te bëjmë me disa gjera ti cilat janë shumë të thjeshta edhe te edukata fizike dhe te lëndët e tjera qe ju duhen, si në matematik topat kualitativ dhe të cilësisë së lart?

Sa shkolla tonë janë pastërti në aspektin higjenik për mbajte të një procesi mësimorë dhe sa punëtorë teknik angazhohen që ata nxënës të posedojnë një klasë të pastër. Sa janë këshille të prindërve në nivel komunal, d.m.th. a ekzistojnë dhe si funksionojnë?

Sallat sportive të ndërtohen sipas standartit si dhe sipas rregullave të sporteve që ne i promovojm te lojërat sportive.

z.Zahir Doda : Furnizimi me material shpenzues ka telashe përherë me këto tenderat mirëpo kjo nuk është në dorën time, po mundohem me ju nejt gati së paku te shkollat profesionale dhe ju kemi dhënë prioritet kabineteve, i kanë një numër të pajisjeve të cilat i kemi dhuratë nga Ministria e arsimit e cila ka pasur një projekt dhe na kanë dhënë për tri sallat, deri më tanë na u kanë përgjigjur pozitivisht.

Te dixhitalizimi , po mundo hemi me kapacitet tonë që kemi, kam shpërndarë tabelat dixhitale thuaja ne të gjitha shkollat këtë vit, prapë i kam edhe 20,000.00 euro vetëm për pajisjet e IT-së, në vitin e kaluar kanë qenë afërsisht 6 milion euro të planifikuara për pajisjet IT-së, ndërsa prej ministrisë së arsimit nuk është realizuar asnjë, arsyesa është se ju ka dështuar tenderi edhe për shkak atyre ankesave nuk kanë mundur me realizua asgjë.

Kanë qenë të planifikume dhe na kanë thirr neve komunave, ne i kemi dorëzuar komplet për dy shkollat e mesme dhe dy shkollat filllore, pasi që e kemi pas për vite e vite me radhë prioritet dy shkollat e mesme dhe dy shkollat ma të mdhaja “Emin Duraku” dhe “Idriz Seferi”, pra te gjitha te dhënat kanë shkuar për këto katër shkolla, është dashtë vitin e kaluar me marrë donacionin por nuk e kemi marr mirëpo askush as në Kosovë nuk ka marr asgjë.

Te pastërtia, problemin ma te madhin e kemi në shkollën “Emin Durak” në Dushkaj, sidoqoftë sinqerisht po ju them pikën e parë kur shkoj nëpër shkolla që e shikoj është kjo , po dua me shti në funksion me pas sapun, me pas letër 70% , në shkolla e gjejmë sapun e gjejmë letrën higjenike dhe relativisht mirë është por siç e ceka gjendjen kritike e kemi në “Emin Durak” ku nuk jemi duke lëviz pozitivisht edhe pse kemi investuar mjaftueshmë por nuk e di ndoshta është për shkak numrit të madh ë fëmijëve.

Segmenti i veçantë i imi është që nuk lë shkollë pa hy me e shiqua në pjesën e higjenës, sa herë qe shkoj dëshiroj me pas gjendjen më të mirë por ajo qe është është. Unë më shumë i kam kushtuar rëndësi pjesës së ndërtimit në të gjitha shkollat, mos të them në të gjitha sepse ka disa që nuk e kanë edhe mënyrën hixhenike për personat me aftësi kufizuara, po thuajse në këto projektet e reja çdo kund ku kemi investuar edhe në Gjimnaz, Emin Durak dhe çdo kund tjetër ku do qe është investua që të paktën me ju dhënë qasje dhe prioritet. Prioritet e kam me ju ndihmua prindërve të cilët i kanë fëmijët me nevoja të veçanta, nuk ka fëmijë në komunë qe nuk e subvencionoj me një pjesë të udhëtimit dhe ndihmave për ti trajtuar, edhe në qendra tjera na funksion perfekt kam numër të mjaftueshmë të psikologeve nëpër shkolla, kur kam marr detyrën nuk ka pasur pas vetëm një ka qenë tanë janë gjashtë mundohem me ju ndihmua .

Këshilli i prindërve funksionon z.Emrin Dema është Kryetar i këshillit prindërve në nivel komunal .

z.Arben Thaqi : Te Programi tek Mali, përcaktimi i shkollave qysh është berë sepse unë qe punoj në shoqatë kemi pasur takim me një pjesë të profesorëve dhe nxënëseve të cilët kanë pas edhe reagime, si është kriteri pasi qe kam dëgjuar qe për baze është marre testi arritshmeris, nuk e di a është e saktë apo jo dua ta di në bazë cilave kriterieve është berë përzgjedhja e nxënëseve për me marr pjesë në atë projekt.

z.Zahir Doda : E para kriter numër një është që ata vet e kërkojnë qe kryesisht me i përfshij shkollat e mëdha, janë vetëm nxënësit e klasave shtata, klasa shkon nuk mundem me zgjedh individ aty qëlluan çka qëlluan, aty minden me qëllu hiq joprofesional por megjithatë klasa shkon, edhe ne jemi munduar me ruajt një renditje kemi marre për kriter edhe rezultatet e shkollave edhe numrin me përshtat sepse ato i kërkojnë 40 nxënës, andaj unë duhet me i kombinua ose një shkollë qe i ka 40 nxënës ose ka dy shkolla për shembull në vitin e parë ka shkuar Kaçanik i vjetër , vitin e dyte ka qenë Dubrava si shkollë e madhe dhe pjesën rural , viti tret ka shku Biçeci edhe Elezajt.

z.Betimi Shala : Për shkollat profesionale rrëth drejtimeve të reja a ka ndonjë ndryshim me u hap drejtime të reja të cilat janë më atraktive si p.sh. me u hap drejtimi i arkitekturës , gjeodezisë apo drejtimi i mjekësisë dhe e jo me qenë vetëm drejtimi i elektros dhe makinerisë te cilat janë 20 vite e më shumë.

z.Zahir Doda : Tani pasi që na kanë dhënë një farë mundësie për mësim dual, kemi mundësi me hap drejtim veç një gjeneratë me përcjell, me marr prej bizneseve një fluktare apo rrobaqepësi dhe me paguaj si profesor këtë te drejtë e kemi ka qene pilot projekt nxënësit me shumë bëjnë praktik , praktikën e kryen zakonisht ne qatë lami edhe në shkollë i krijojmë qatë mundësi dhe i lëshohen certifikatat kurse drejtimet përhershëm e kam problem stafin.

3.Të ndryshme:

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme ? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 14:00.

Procesmbajtësja
Mavije Murseli



Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka

